



MAKING DEMOCRACY WORK

**VEZHGIM STUDIMOR MBAREKOMBETAR
ME
ANETARET E KOMISIONEVE ZGJEDHORE
TE QEVERISJES VENDORE DHE ZONAVE
ZGJEDHORE
2001**

Rezultatet e Vezhgimit te IFES

**Vezhgim i kryer per
Komisionin Qendror te Zgjedhjeve, Shqiperi**

Pergatitur nga: Fondacioni Nderkombetar per Sistemet e Zgjedhjeve,
Shqiperi
Prill 2002

PERMBAJTJA

HYRJE	1
PJESA E PARE: PROJEKTI I VEZHIMIT STUDIMOR PER KOMISIONERET	2
PJESA E DYTE: REZULTATET E VEZHIMIT STUDIMOR ME KOMISIONERET ZGJEDHORE TE SHQIPERISE	4
1. TE DHENA TE PERGJITHSHME PER KOMISIONERET E ZGJEDHJEVE TE SHQIPERISE	4
A. Te dhena Demografike	4
B. Perfaqesimi politik ne komisionet zgjedhore	6
2. NJOHJA E DETYRAVE DHE ROLIT TE KOMISIONERIT	7
A. Eksperienca si Komisioner	7
B. Roli dhe Pergjegjesite e Komisionereve Zgjedhore	7
C. Pergjegjesia Kryesore e Komisionereve	8
D. Sanksionet dhe Veprimet Disiplinore	9
3. PUNA E KOMISIONEREVE ZGJEDHORE GJATE ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE 2001	9
A. Krahasimi i Zgjedhjeve Parlamentare 2001 me Zgjedhjet e Meparshme	9
B. Kushtet dhe Pajisjet	10
C. Marredheniet midis Komisionereve dhe Vendimarrja	10
D. Ankesat nga Zgjedhësit e te tjeret	11
E. Parregullsi gjate Zgjedhjeve	12
F. Roli i Partive Politike	13
G. Roli i Policise	14
4. PROBLEME NE ADMNISTRIMIN E ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE 2001	14
A. Fushat me problematike	14
B. Lista e Zgjedhesve	15
C. Tabela e rezultateve	15
D. Zgjidhje te Mundshme	16
5. TRAINIMI DHE PERGATITJA	16
A. Perdorimi i Kodit Zgjedhor dhe Manualeve	16
B. Perdorimi i Trainimit	16
C. Mendimi ne lidhje me trainimin	17
D. Shoqata e Zgjedhjeve	18
E. Media Efektive per Komisioneret dhe Zgjedhësit	19
6. VLERESIMI PER KOMISIONIN QENDROR TE ZGJEDHJEVE	19
A. Komunikimi me KQZ	19
B. Asistenca e ofruar nga KQZ	20
C. Dokumentacioni i KQZ-se	22
7. DEMOKRACIA	23
A. Kuptimi i Termit “Zgjedhje te Lira e te Ndershme”	23
B. Kuptimi i te Jetuarit ne Demokraci	23
PJESA E TRETE: KOMENTE DHE VLERESIME TE IFES	24
1. PERBERJA DEMOGRAFIKE E KOMISIONEVE ZGJEDHORE	24
2. PERFAQESIMI I PARTIVE POLITIKE DHE KUPTIMI I PERGJEGJESIVE NGA KOMISIONERET	24
3. PUNA GJATE ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE 2001	25
Ankesat	26
Probleme ne Admnistrimin e Zgjedhjeve	26
Trainimi dhe Shoqata e Komisionereve Zgjedhore	27
Edukimi Qytetar dhe Perdorimi i Medias si Mjet Informimi per Komisionet Lokale	27
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	27
SHTESE 1 – PYETESORI PER KOMISIONERET	28

Hyrje

Qellimi i ketij raporti eshte te paraqese rezultatet kryesore te vezhgimit te pare mbarekombetar per komisioneret zgjedhore ne Shqiperi organizuar gjate muajve Nentor dhe Dhjetor 2001. Gjate kesaj periudhe u intervistuan komisioneret e Komisioneve Zgjedhore te Qeverisjes Vendore (KZQV) dhe komisioneret e Komisioneve te Zonave Zgjedhore (KZZ), per te marre mendimin e tyre ne lidhje me nje sere ceshtjesh qe lidhen me administrimin e zgjedhjeve dhe eksperiencen e tyre gjate zgjedhjeve per Kuvendin te vitit 2001. Ky raport eshte pergatitur per Komisionin Qendror te Zgjedhjeve nga Fondacioni Nderkombetar per Sistemet e Zgjedhjeve, duke ndjekur nje analizim te gjere te rezultateve. Rezultatet e vezhgimit, nenvizojne permiresimet qe jane percaktuar si te tilla nga komisioneret si dhe fushat ku duhet te perqendrohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, komisionet lokale dhe partite politike, per zgjedhjet lokale 2003.

Ky raport eshte i perbere nga tre pjese. Pjesa e pare permban nje paraqitje te pergjithshme te projektit, strukturen e pyetesorit dhe sistemin e klasifikimit per grupimin e pergjigjeve te ketij raporti. Pjesa e dyte e raportit permban rezultatet kryesore bazuar ne te dhenat e mbledhura dhe te analizuara nga IFES. Per nje referim me te thjeshte, rezultatet jane paraqitur si ne perqindje ashtu edhe ne numer. Ne pjesen e trete te ketij raporti IFES ka paraqitur komente dhe vleresime ne lidhje me disa nga ceshtjet e paraqitura, ne kontekst te kerkesave dhe permiresimit qe kerkon sistemi i zgjedhjeve ne Shqiperi.

PJESA E PARE: Projekti i Vezhgimit Studimor per Komisioneret

Zgjedhjet e Qershorit 2001 per Kuvendin e Shqiperise ishin zgjedhjet e dyta ne nente muaj. Te dy keto procese u kryen ne baze te nje kodi te ri zgjedhor (miratuar nga Kuvendi me 8 Maj 2000), te administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i formalizuar me miratimin e Kodit te ri Zgjedhor ne Maj 2000, krijimin e nje liste te re zgjedhesish ne mes te vitit 2000, te rishikuar ne pranvere 2001. Gjithashtu, me perfundimin e zgjedhjeve per Kuvendin 2001, KQZ mori per here te pare vleresime nga komisioneret lokale (KZQV-te e bashkive dhe komunave dhe KZZ-te per zonat zgjedhore). IFES i paraqiti KQZ-se idene e nje vezhgimi studimor per komisioneret zgjedhore per te marre mendimin e tyre ne lidhje me organizimin e zgjedhjeve. Me miratimin dhe ne bashkepunim me KQZ-ne, IFES hartoi dhe ndermori kete vezhgim studimor duke identifikuar disa objektiva:

- Marrjen e mendimit te komisionereve ne lidhje me probleme dhe ceshtje te ndryshme te administrimit te zgjedhjeve
- Mendimin e komisionereve te komisioneve zgjedhore ne lidhje me ndershmerine e zgjedhjeve te Qershorit 2001.
- Interesin e tyre ne krijimin e nje Shoqate per Komisioneret Zgjedhore.
- Dhenien e informacionit per KQZ
- Percaktimin e fushave te administrimit te zgjedhjeve qe kerkojne permiresim sipas mendimit te komisionereve.
- Asistimin e KQZ-se ne percaktimin e prioriteteve ne pergatitje per zgjedhjet lokale 2003.
- Mbajtjen e nje linje komunikimi ndermjet KQZ dhe komisionereve lokale

Ne Nentor dhe Dhjetor 2001, ne te gjithe Shqiperine u intervistuan 2,972 komisionere, prej te cileve 2,446 ishin anetare te komisioneve zgjedhore te qeverisjes vendore dhe 624, anetare te komisioneve te zonave zgjedhore, duke perdorur nje strukture te nderthurur midis pyetesorit te strukturuar dhe intervistes. Pyetesori permbante 144 pyetje dhe mbulonte ceshtje qe lidheshin me demografine, rolin e komisionereve ne procesin zgjedhor, KZQV-te dhe KZZ-te gjate zgjedhjeve 2001, marredheniet me KQZ-ne dhe veprimtari te pergjithshme sociale e politike.

Ky pyetesor kerkon qe komisioneret te zgjedhin pergjigjet prej nje liste te paracaktuar ose te japin tre te tjera. Per disa pyetje eshte lene edhe opsioni "Nuk e di" nese komisioneret nuk kane dijeni ne lidhje me ceshtjen ne fjale. Nje opsion tjeter ka qene edhe "Nuk pergjigjet" dhe do te shenohej nese komisioneri nuk ishte i prirur te pronocohej per ceshtjen ne fjale.

Rezultatet jane paraqitur ne disa formate per arsye analizimi dhe keto perfshijne: pergjigjet per pyetje te vecanta, krahasimin e pergjigjeve te KZZ-ve dhe KZQV-ve, krahasimin ne baze prefektore si dhe krahasimin ne baze te dendesise se popullsise. Duke pare shtrirjen e gjere te popullsise ne Tirane, te intervistuarit e Tiranës jane te grupuar, duke u ndare nga zonat urbane qe permbajne me teper se 10,000 banore, zonat gjysme-urbane me 3,000 deri 9,999 banore dhe zonat rurale me popullsi me pak se 3,000 banore. Duke grupuar rezultatet, ka qene e mundur te percaktohen ngjashmerite dhe ndryshimet ne te dhenat perkatese. Zonat qe jane identifikuar si problematike 1, 8, 9, 14, 33, 38, 49, 60, 86 dhe 98 jane percaktuar si nje grup i vecante kur kane diskutuar problemet e hasura gjate ketyre zgjedhjeve. Se fundi, me kerkesen e KQZ-se, nuk eshte bere analize ne baze te partive politike, me perjashtim te rasteve kur jane diskutuar emerimet e komisionereve nga partite dhe anetaresia e komisionereve.

Per here te pare ne Shqiperi, mbi 80% e komisionereve te KZQV-ve dhe KZZ-ve kane patur mundesine te shprehin mendimet e tyre drejtperdrejt per KQZ-ne ne lidhje me shume aspekte te procesit zgjedhor. Ne pergjithesi komisioneret kane qene te interesuar te japin intervisten dhe te shprehin mendimet e tyre ne lidhje me ceshtjet e mbuluara nga intervista, megjithese nje numer komisioneresh ka permendur faktin se kane veshtiresi te mbajne mend ngjarjet sepse kane kaluar pese muaj qe nga zgjedhjet parlamentare.

PJESA E DYTE: Rezultatet e vëzhgimit studimor me komisioneret zgjedhore të Shqiperise

1. TE DHENA TE PERGJITHSHME PER KOMISIONERET E ZGJEDHJEVE TE SHQIPERISE

A. Te dhena Demografike

- Gjate Vëzhgimit Studimor u intervistuan 2,972 komisionere. Kjo shifer perfaqeson afersisht 80% (3,070) te te gjithë anetareve të emeruar (3,880) në KZZ (800) dhe KZQV(3,080). Per te gjithë te intervistuarit është përdorur i njëjti pyetesor, me përjashtim të seksionit që përfshinte pyetjet drejtuar komisionereve të KZQV-ve dhe KZZ-ve.
- Prej te intervistuarve, 21% (624) ishin anetare të KZZ-ve dhe 82% (2,446) ishin anetare të KZQV-ve. 96 prej te intervistuarve, (3.2%), prej 2,972 ishin anetare të KZZ-ve dhe KZQV-ve së bashku. Prej tyre, vetëm 2% e te intervistuarve deklaruan se ishin anetare edhe të KQV-ve për zgjedhjet e vitit 2001. Nga këta 2%, të gjithë përveç njerit prej te intervistuarve thanë se kanë qenë anetare të KZQV-ve për zgjedhjet parlamentare.

Figure 1: Numri i KZZ-ve dhe KZQV-ve të kontaktuar dhe Numri i Komisionereve të Intervistuar


Prefektura	Numri i KZQV-ve të Kontaktuar	Numri i Anetareve të KZQV-ve të Kontaktuar	Prefektura	Numri i KZZ-ve të Kontaktuar	Numri i Anetareve të KZZ-ve të Kontaktuar
BERAT	25	198	BERAT	7	55
DIBER	35	219	DIBER	5	34
DURRES	15	80	DURRES	8	38
ELBASAN	50	376	ELBASAN	11	84
FIER	39	248	FIER	12	78
GJIROKASTER	31	192	GJIROKASTER	4	26
KORCE	35	224	KORCE	9	45
KUKES	27	191	KUKES	3	21
LEZHE	21	199	LEZHE	5	38
SHKODER	32	226	SHKODER	8	56
TIRANE	34	189	TIRANE	19	112
VLORE	23	104	VLORE	7	37
TOTAL	367	2,446	TOTAL	98	624

Numri i Komisionereve dhe Komisioneve Zgjedhore

Numri i KZQV-ve	Numri i Anetareve të KZQV-ve	Numri i KZZ-ve	Numri i Anetareve të KZZ-ve
385	3,080	100	800


- Vezhgimi studimor tregon se shumica e komisionereve ne Shqiperi jane te seksit mashkull, pra 94% (2,792) ne krahasim me 6% (180) qe jane te seksit femer. Numer me i madh komisioneresh femra ne krahasim me mesataren, vihet re ne Tirane (15%/39), Vlore (8%/11), Elbasan (7%/32), Gjirokaster (7%/15), Durres (7%/8), dhe Korce (7%/17). Prefekturat e Kukedit dhe Dibres kane edhe numrin me te vogel te femrave, te dyja nga 2% (5 ne Diber dhe 4 ne Kukes).

Figure 2: Raporti i perfaqesimit ne KZQV dhe KZZ




- Kodi Zgjedhor parashikon qe anetaret e KZZ-ve duhet te kene arsimin e larte, nderkohe qe anetaret e KZQV-ve si rregull duhet te kene arsimin e larte (nenet 32 dhe 38). Kjo kerkese nuk u respektua nga te gjitha partite te cilat kishin te drejte te propozonin anetare per ne KZZ dhe KZQV, po ashtu edhe nga KQZ-ja gjate procesit te emerimit te tyre. 50% (1,486) e pjesemarresve ne vezhgim kane arsimin e larte, ndersa 43% (1,266) kane arsimin e mesem dhe 7% (220) me arsim tetevjecar. Niveli arsimor vjen ne ulje ne zonat gjysem urbane dhe rurale. Ne Tirane, 85% (66) e komisionereve kane arsimin e larte, ne krahasim me 66% (140) te komisionereve ne zonat urbane, 49% (390) ne zonat gjysem urbane dhe 32% (440) ne zonat rurale.
- Ne nivelin e KZZ-ve, 85% (530) e komisionereve kane arsimin e larte, ndersa 14% (89) e tyre kane arsimin e mesem.
- Ne nivelin e KZQV-ve, 42% (1,036) e tyre kane arsimin e larte, 49% (1,192) kane arsimin e mesem, dhe 9% (218) arsimin tetevjecar.
- Sekretaret e KZZ-ve me ligj duhet te jene juriste, ndersa sekretaret e KZQV-ve jane edhe sekretare te bashkive apo komunave. Nga sekretaret e intervistuar, 71% (264) kishin arsimin e larte, ndersa per sekretaret e KZQV-ve ky numer bie ne 38% (806).

Figure 3: Niveli Arsimor i Komisionereve ne KZQV dhe KZZ



- Shumica e anetareve te komisioneve ishin ne moshen midis 36 deri 55 vjec (71%/2,097). Tete perqind (250) ishin midis moshes 56 dhe 72 vjec, 17% (509) ishin midis 26 dhe 35 vjec, dhe 1% (42) midis 18 dhe 25 vjec.

Figure 4: Moshja e Komisionereve ne KZZ dhe KZQV



B. Perfaqesimi politik ne komisionet zgjedhore

- Sipas neneve 32 dhe 38 te Kodit Zgjedhor, KZQV-te dhe KZZ-te perbehen nga shtate anetare plus sekretarin, cdo anetar komisioni caktohet nga nje nga shtate partite e perfaqesuar ne Kuvendin e Shqiperise. Sekretaret e KZZ-ve emerohen nga KQZ-ja ne baze te propozimit te KZZ-se dhe duhet te jene juriste. Sekretaret e KZQV-ve automatikisht jane edhe sekretare te bashkive ose komunave. Sekretaret nuk caktohen nga partite politike, megjithate sekretaret e bashkive dhe komunave jane emerime politike te cilat behen nga qeveria. Tabela e meposhtme tregon edhe numrin e komisionereve te emeruar nga KQZ-ja sipas propozimeve te bera nga partite si dhe perqindjen e atyre komisionereve te cilet deklaruan se ishin anetare te partise e cila i kishte propozuar. Tabela nuk perfshin sekretaret.

Figure 5: Komisioneret e Emeruar nga Partite Politike & Anetaresia

Partite Politike	%/Totale e Komisionereve te Emeruar nga Partite Politike	Komisioneret qe jane anetare Partie	% e Anetareve te komisioneve qe jane anetare te Partise qe i ka emeruar
Agrare (PA)	5,1%/132	111	84%
Aleanca Demokratike (PAD)	12,5%/324	215	66%
Bashkimi per te Drejtat e Njeriut (PBDNJ)	9,4%/245	180	73%
Kristian Demokrate (PDK)	2,5%/65	54	83%
Balli Kombetar (PBK)	3,9%/101	82	81%
Partia Demokratike e Shqiperise (PDSH)	16%/416	469	113%
Levizja e Legalitetit (PLL)	4,1%/108	45	42%
Partia Republikane (PR)	13,1%/341	249	73%
Partia Socialiste (PS)	16,6%/431	399	92%
Social Demokrate (PSD)	14,1%/367	310	84%
Tjeter	2,4%/62	57	92%

- Ne pergjithesi (duke përfshirë edhe sekretaret) 16,7% (497) e të intervistuarve deklaruan se nuk ishin anetare të ndonjë partie politike. Nëse heqim sekretaret, përqindja e anetareve pa parti bie në 15,6% (406). Pothuajse çdo parti, me përjashtim të njërës (PDSH), kishin propozuar një numër komisioneresh të cilët nuk ishin anetare të tyre.
- Siç edhe tregohet në tabelën e mësipërme, komisionerët të cilët deklarorin anetarisinë e tyre në PDSH (469) e kalojnë numrin e komisionereve të emëruar nga KQZ-ja (416). Pas një ekzaminimi të mëtejshëm, u vu re se një sërë partish të vogla si PDK, PLL dhe PR të cilat ishin në koalicion me PD-në kishin propozuar 80 anetare të PD-së për t'i përfaqësuar ato në komisione. Kjo mënyrë nuk vihet re aq shpesh për anetaret e PS-së. Vetëm 20 anetare të PS-së përfaqësonin në komisione, partitë e tjera të vogla aleate të PS-së.

2. NJOHJA E DETYRAVE DHE ROLIT TË KOMISIONERIT


A. Eksperiencat si Komisioner

- Pjesa më e madhe e komisionereve që u intervistuan kanë eksperiencë të mëparshme në procesin zgjedhor në Shqipëri. 54% (1,613) e komisionereve kanë punuar në zgjedhjet lokale 2000, 33% (985) gjatë zgjedhjeve parlamentare 1997 dhe 27% (791) gjatë zgjedhjeve lokale 1996. Në total 17% (497) e komisionereve kanë punuar në të gjithë zgjedhjet e përmendura, 16% (470) në tre zgjedhje dhe 32% (958) në dy zgjedhjet e shkuara. 36% e komisionereve kanë patur zgjedhjet parlamentare 2001 si eksperiencën e tyre të parë me zgjedhjet. Nga 2,972 komisionerë të intervistuar vetëm 61 kanë patur eksperiencë pune në të tre komisionet e ndryshme (të zonës, të qeverisjes vendore dhe qendres së votimit), 65% e të intervistuarve kanë përmendur eksperiencën e tyre në të tre pozicionet e komisionit, kryetar, zëv/kryetar dhe anetar.

B. Roli dhe Përgjegjësitë e Komisionereve Zgjedhore

- Pjesa më e madhe e komisionereve të intervistuar janë informuar në lidhje me aspektet administrative të punës së tyre. 99% (2,998) e të intervistuarve kanë deklaruar se janë informuar në lidhje me rolin dhe detyrat e tyre si komisioner. 96% (2,847) e tyre janë informuar në lidhje me orarin e mundshëm të punës. 89% (2,631) janë informuar në lidhje me kushtet e punës, ndërsa pothuajse ¼ deklaruan se nuk ishin informuar në lidhje me pagën që do të marrin. 76% (2,266) kanë thënë se kanë qenë të informuar dhe 24% (703) se nuk kanë qenë të informuar. Ky është edhe niveli më i lartë i mungesës së informacionit në lidhje me ceshtjet administrative, deklaruar nga komisionerët.
- Me tepër se 9 nga 10 komisionerë të intervistuar (93%/2,751) kanë thënë se janë të informuar në lidhje me shkaqet e ndeshkimit të një komisioneri. Kur janë pyetur për të dhëna një liste të shkaqeve për të cilat një komisioner mund të shkarkohet nga detyra, pothuajse të gjithë janë përgjigjur "shkelja e ligjit" (96%/2,858), arsye të tjera janë përmendur mungesë disiplinë (54%/1,614), me kërkesë të partive politike (46%/1,387), mospjesëmarrje (30%/895) dhe nivel i pamjaftueshëm arsimor (24%/718).
- Komisionerëve i është kërkuar të listojnë detyrat e tyre kryesore si komisioner. Përgjigjet më frekvente kanë qenë zbatimi i ligjit (87%/2,590), e ndjekur nga: të lejojnë personat të votojnë lirisht (49%/1,464), të njohin ligjet dhe manualët e KQZ-së (38%/1,134) dhe të jenë të pranishëm në mbledhje (36%/1,076). Në bazë të mendimeve të komisionereve, detyrat e tyre kryesore janë të sigurojnë se ligji zgjedhor është zbatuar dhe se zgjedhësit kanë mundësinë të votojnë lirisht. Këto detyra idealiste, kapërcejnë ato si p.sh të qenit të pranishëm në mbledhje.


Figure 6: Detyrat kryesore sic jane percaktuar nga komisioneret e KZQV dhe KZZ



C. Pergjegjësia Kryesore e Komisionereve

- Ky vzhgim ka patur si qellim te percaktoje menyren se si komisioneret e shohin veten dhe rolin e tyre. Pyetja ka qene nese ata e konsiderojne veten si perfaqesues te partise politike qe i ka emeruar, si punonjes te KQZ-se, apo si persona qe u sherbejne votuesve dhe te intervistuarit mund te jepnin me shume se nje pergjigje. 64% e te intervistuarve e kane konsideruar veten si punonjes te KQZ-se (1,905) dhe si persona qe u sherbejne votuesve (1,888), ndersa nje perqindje me e vogel (34%/1,905) e shohin veten si perfaqesues te partise politike qe i ka emeruar. Duke perjashtuar sekretaret, komisioneret e KZQV-se e shohin veten me teper ne rolin e personit qe i sherben votuesve (64%/ 1,564), ndersa komisioneret e KZZ-se jane me teper te prirur ndaj rolit te tyre si punonjes te KQZ-se (71%/442). Kryetaret dhe sekretaret ne KZQV me teper e konsiderojne veten si punonjes te KQZ-se, ndersa zv/kryetaret dhe anetaret e shohin veten me teper ne rolin e perfaqesuesit te partise politike qe i ka emeruar. E njejta gje vlen edhe per komisioneret e KZZ-ve.

Figure 7: Pergjegjësia Kryesore e Komisionereve te KZZ dhe KZQV



D. Sanksionet dhe Veprimet Disiplinore


- Te intervistuarit jane pyetur se cilat jane sanksionet qe do te zbatoheshin ndaj nje komisioneri i cili nuk zbaton vendimet dhe udhezimet e KQZ-se. Me teper se tre te katertat e te intervistuarve jane dakord se nje sanksion do te ishte shkarkimi nga detyra si komisioner (77%/2,287). Nje pjese e madhe e te intervistuarve (63%/1,874) kane percaktuar edhe gjoben si nje nga sanksionet. Me teper kjo eshte vene re te komisioneret e Gjirokastrës (82%/173), Korces (75%/196), Kukesit (72%/150) dhe Beratit (71%/177). 19% (551) kane pranuar burgosjen si nje sanksion. Kjo tendence vinte ne rritje ne ata komisionere qe kane punuar ne disa zgjedhje. Vetem 3% (101) mendojne se eshte e mjaftueshme nje mase ndeshkimi shume e vogel.

3. PUNA E KOMISIONEREVE ZGJEDHORE GJATE ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE 2001

A. Krahasimi i Zgjedhjeve Parlamentare 2001 me Zgjedhjet e Meparshme

- Te intervistuarve u eshte kerkuar te krahasojne administrimin e zgjedhjeve parlamentare 2001 me zgjedhjet e meparshme ne Shqiperi. Pak me teper se gjysma (55%/1,625) mendojne se zgjedhjet parlamentare 2001 ishin me te mireorganizuara se te meparshmet, 27% (790) mendojne se niveli i administrimit ka qene i njejte, ndersa 10% (283) mendojne se administrimi i zgjedhjeve eshte me i dobet se me pare. Komisioneret e KZZ-ve kane qene me kritike ndaj zgjedhjeve parlamentare se ta te KZQV-ve. Duke krahasuar KZZ-te me KZQV-te, 56% (1,373) e komisionereve te KZQV-ve mendojne se zgjedhjet jane me te mireadministruara nderkohe qe kjo perqindje eshte 50% (310) per komisioneret e KZZ-ve. Gjithashtu perqindja e komisionereve te KZQV-ve qe i konsiderojne keto zgjedhjet ne nivel me te ulet administrimi se te meparshmet eshte 9% (208), krahasuar me 14% (87) te komisionereve te KZZ-ve.
- Perqindja e komisionereve qe i vleresojne pozitivisht zgjedhjet parlamentare 2001 vjen ne rritje me rritjen e eksperiencës qe kane patur komisioneret ne zgjedhjet e meparshme. 49% (515) e atyre qe kane punuar per here te pare ne keto zgjedhje mendojne se keto zgjedhje kane qene me te mireadministruara, kundrejt 54% (518) te atyre per te cilat keto zgjedhje kane qene eksperiencia e dyte. Ky mendim eshte gjithnje ne rritje duke patur nje perqindje prej (58%/ 273) per ata qe kane punuar ne tre zgjedhje dhe (64%/ 319) e atyre qe kane punuar ne kater zgjedhjet e meparshme.
- Ka patur variacione domethenese nga nje vend ne tjetrin ne lidhje me keto pyetje. Komisioneret e prefektures se Fierit (217) dhe Gjirokastrës (149) mendonin se keto zgjedhje kane qene me te mira se ato te meparshmet (70%) secili. Nga ana tjetere, me pak se gjysma e komisionereve ne Vlore (30%/41), Shkoder (36%/101), Diber (44%/110) dhe Tirane (46%/126) i kane vleresuar pozitivisht keto zgjedhje. Ashtu sikurse pritje ne zona qe kane patur probleme, anetaret e KZZ-ve ishin me pak te mendimit se zgjedhjet kane qene te mira ne krahasim me zonat ku nuk ka patur probleme (45%/33 krahasuar me 51%/ 277).

Figure 8: Zgjedhjet 2001 Krahasuar me Zgjedhjet e Meparshme



B. Kushtet dhe Pajisjet


- Pothuajse te gjithe komisioneret kana raportuar se kane patur zyra pune gjate zgjedhjeve parlamentare 2001 (99%/3,041) dhe pjesa me e madhe ka deklaruar se kane patur telefon (69%/1,670 KZQV dhe 94%/583 KZZ), ka patur gjithashtu shume komisionere qe nuk kane patur mjetet kryesore te komunikimit. Ne pergjithesi KZZ kane qene me te pajisur se KZQV-te. 20% (127) e komisionereve te KZZ-ve jane pergjigjur se kane patur faks ne dispozicion. Ne rastin e fotokopjes pergjigjet kane qene 27% (169) e komisionereve te KZZ dhe 18% (441) e atyre te KZQV-se dhe persa i perket kompjuterit keto pergjigje kane qene 16% (102) e KZZ-ve krahasuar me 8% (196) te KZQV-ve.
- Pajisjet jane influencuar gjithashtu nga vendndodhja. Me perjashtim te zyrave, ne zonat gjysem urbane dhe rurale ka patur me pak akses persa i perket telefonit, faksit, fotokopjes, kompjuterave e printerave. Cuditerisht nje perqindje e ngjashme e komisionereve ne Tirane (me zonat rurale dhe gjysme rurale), kane raportuar se nuk kane patur pajisjet e mesiperme (me perjashtim te telefonit).

C. Marredheniet midis Komisionereve dhe Vendimmarrja

- Pjesa me e madhe e komisionereve si per KZQV-te ashtu edhe per KZZ-te mendojne se marredheniet ndermjet komisionereve kane qene te mira dhe shume te mira. (97%/2,383 KZQV dhe 89%/ 553 KZZ). Komisioneret e KZZ-ve ne zonat problematike kane qene me te prirur te thone se marredheniet ndermjet komisionereve nuk kane qene te mira. Arsyet per marredhenie jo te mira kane qene: perkatesia e ndryshme politike; shkelje te kodit zgjedhor; dhe komisioneret qe bllokoni procesin.

- Ndryshimet midis KZQV-ve dhe KZZ-ve ne kete pyetje jane vene re kur komisioneret jane pyetur ne lidhje me marredheniet me organet e qeverisjes vendore. 96% (2,355) e komisionereve te KZQV dhe 88% (549) e anetareve te KZZ-ve mendojne marredheniet kane qene te mira dhe shume te mira. Komisioneret e KZZ-ve ne Tirane dhe ne zonat rurale mendojne se marredheniet kane qene jo te mira (26%/6 dhe 17%/1 respektivisht), perqindjet per komisioneret e KZZ-ve ne zonat e tjera urbane e gjysme urbane, pervec Tiranes, jane respektivisht 6% (2) dhe 9% (3).
- Ata qe mendonin se marredheniet me qeverisjen vendore nuk kane qene te mira mendonin se vendimmarrja ne komision nuk ka qene e drejte (29%/20 per KZQV-te dhe 41%/28 per KZZ-te) ne krahasim me ata qe mendojne se marredheniet kane qene te mira (5%/52 per KZQV-te dhe 12%/43 per KZZ-te).
- Komisioneret e KZZ-ve jane pyetur ne lidhje me marredheniet me Komisioneret e Qendrave te Votimit (KQV) ne zonen e tyre. 95% (590) e komisionereve te KZZ-ve mendojne se marredheniet kane qene 'shume te mira' dhe 'te mira'.
- Ka nje ndryshim midis anetareve te KZZ-ve dhe atyre te KZQV-ve kur jane pyetur ne lidhje me mendimin qe kane per vendimmarrjen ne komisionin e tyre per zgjedhjet parlamentare 2001, ndersa per KZQV-te 93% (2,265) mendojne se vendimmarrja ka qene e drejte dhe 3% (86) mendojne se jo, ka nje ndryshim ne perqindje per KZZ-te, ku 83% (518) e anetareve mendojne se vendimmarrja ka qene e drejte dhe 13% (82) mendojne se nuk ka qene e tille. Ndermjet anetareve te KZZ-ve, ata te Duresit (8), Dibres (7) dhe Fierit (16) (me 21% secili) dhe Gjirokastrës (5) e Tiranes (21) (19% secila) kane qene me teper te mendimit se vendimmarrja nuk ka qene e drejte.

Figure 9: Drejtësia ne Vendimmarrje ne Komisione



- Mendimet se vendimmarrja nuk ka qene e drejte lidhet edhe me KQZ-ne. Ata qe ne KZZ mendojne se vendimmarrja nuk ka qene e drejte jane me te prirur ndaj pergjigjeve se inspektoret dhe supervizoret e KQZ-se kane qene te njeanshem ne punen e tyre gjate zgjedhjeve parlamentare 2001.

D. Ankesat nga Zgjedhësit e te tjeret

- Me se tre te katertat e komisionereve nga KZZ (81%/501) dhe KZQV-te (76%/1,857) kane raportuar se komisionet zgjedhore kane patur ankesa nga zgjedhësit gjate zgjedhjeve parlamentare. Komisioneret e partive te koalicionit qeveritar ishin me pak te prirur te pranonin se ka patur ankesa nga zgjedhësit. Pjesa me e madhe e ankesave kishin te benin me mungesa ne listat e zgjedhësve, vendosjen ne qendren e gabuar te

votimit, gabime ne shkrimin e emrave, emra te dublikuar dhe emra personash te vdekur ne lista. Keto probleme jane permendur kryesisht nga KZQV-te se bashku me ato qe lidhen me kartat e zgjedhesve. Pervec ankimeve per listen e zgjedhesve qe zinin 71% (527), komisioneret e KZZ-ve kane listuar edhe probleme te tjera: probleme me policine ose gjykatat (7%/56), vendndodhja e qendrave te votimit (3%/22), presion i papershtashem mbi votuesit (3%/25) dhe zgjedhes qe nuk i njihnin procedurat e votimit (2%/14).

- Per sa i perket KZQV-ve, nje perqindje me e madhe komisioneresh kane raportuar per probleme ne lidhje me ankesat qe vijne nga zgjedhesit. Per KZZ-te, komisioneret e prefekturave Vlore (34) dhe Lezhe (35) (92% secila), kane raportuar me teper probleme me ankesat e zgjedhesve. Komisioneret ne Korce (89%/40) dhe Diber (88%/30) kane raportuar gjithashtu nje nivel te larte ankesash. Ata komisionere te KZQV-ve qe mendojne se koha e rishikimit ka qene e shkurter, kane raportuar per me teper ankesa nga zgjedhesit (86%/359), krahasuar me ata qe kane patur ankesa, por mendojne se koha ne dispozicion ka qene e mjaftueshme (74%/1,440) ose mjaft e gjate (67%/47).
- Komisioneret jane pyetur gjithashtu edhe ne lidhje me kohezgjatjen e procesit te rishikimit te listave te zgjedhesve.
- 17% (418) e komisionereve te KZQV-ve mendojne se koha ka qene shume e shkurter, 79% (1,943) mendojne se koha ka qene e mjaftueshme dhe 3% (70) mendojne se koha ka qene shume e gjate. Komisioneret e prefektures se Tiranes, kane qene mjaft kritike ne lidhje me kete ceshtje. 34% (65) e tyre mendojne se koha ka qene shume e shkurter.
- Kur komisioneret e KZZ-ve jane pyetur ne lidhje me ankimet qe kane patur ne komisionin e tyre, pjesa me e madhe (54%/334) jane pergjigjur se kane patur te tilla dhe 42% (262) kane thene se nuk kane patur ankesa. Ankesa me e permendur ka qene lidhur me gabime ne listat e zgjedhesve (47%/157). Gjithashtu jane permendur edhe konflikte midis komisionereve (28%/95), probleme logjistike (23%/78), tabelat e rezultateve (14%/47) dhe nderhyrja e policise se bashku me nderhyrje te tjera (17%/57).

E. Parregullsi gjate Zgjedhjeve

- Anetaret e KZZ-ve u pyeten nese mendojne se partite politike kane perfituar vota ne menyre te paligjshme (kjo pyetje nuk eshte bere specifike). Me vone ata jane pyetur nese mendojne se rezultatet ne zonen e tyre jane manipuluar dhe se fundi te percaktojne nese zgjedhjet ne zonen e tyre kane qene te ndershme.
- Ne pergjithesi 84% (520) e komisionereve ne te gjithe vendin mendojne se zgjedhjet ne zonen e tyre kane qene te ndershme ne krahasim me 15%(90) qe mendojne se jo. Edhe pse pjesa me e madhe e komisionereve te KZZ-ve mendojne se zgjedhjet ne zonen e tyre kane qene te drejta, ka perseri disa ndryshime te rendesishme rajonale. Komisioneret e Gjirokastres ne 35% (9) mendojne se zgjedhjet ne zonen e tyre nuk kane qene te drejta. Te njejtin mendim kane edhe komisioneret ne Diber (29%/10), Durres (24%/9) dhe Fier (23%/18). Me poshte paraqiten mendimet ne lidhje me votat e paligjshme, manipulimin e rezultateve dhe zgjedhjet ne pergjithesi. Shqetesimet kryesore jane shfaqur ne Gjirokaster, Durres, Diber, Fier dhe Tirane.
- Komisioneret e KZZ-ve nuk jane dakord me shprehjen “partite politike kane perfituar vota ne menyre te paligjshme” ne masen 51% (319). 34% (209) jane dakord me kete shprehje dhe 11% (68) nuk jane pergjigjur. Kjo pyetje ka te beje me zgjedhjet ne pergjithesi dhe jo ne zonen perkatese, megjithate duket se komisioneret i jane referuar

zones se tyre ne pergjithesi. 38% (79) e atyre komisionereve qe mendojne se partite kane perfituar vota ne menyre te paligjshme ne zgjedhjet parlamentare 2001, kane raportuar gjithashtu se zgjedhjet nuk kane qene te drejta ne zonen e tyre (kjo perben 13%/79 te te gjitha komisionereve te intervistuar nga KZZ-te). Duke bere nje krahasim, vetem 1% (3) e atyre qe mendojne se partite kane perfituar vota ne menyre te paligjshme, kane raportuar se zgjedhjet ne zonen e tyre nuk kane qene te drejta. Gjithashtu gjysma e komisionereve te KZZ-ve qe mendojne se partite kane perfituar vota ne menyre te paligjshme, mendojne se rezultatet ne zonen e tyre jane manipuluar (kjo perqindje perfaqeson 17%/104 te te gjitha anetareve te KZZ-ve qe jane intervistuar.)

- Ka nje ndryshim midis zonave te cilat kane patur probleme pas zgjedhjeve dhe atyre qe nuk kane patur te tilla. 50% (13) e komisionereve te KZZ-ve ne Gjirokaster mendojne ka patur perfitime nga vota te paligjshme gjate zgjedhjeve parlamentare 2001. Komisioneret e KZZ-ve ne Shkoder (45%/25), Kukes (43%/ 9), Durres (42%/16) dhe Tirane (40%/44) kane patur nje perqindje me te larte komisioneresh te cilet mendojne se ka patur perfitime nga vota te paligjshme gjate zgjedhjeve te 2001.
- Komisioneret ne Gjirokaster (39%/10), Tirane (29%/32) dhe Durres (26%/10) kane nje perqindje me te larte komisioneresh qe mendojne se rezultatet jane manipuluar. Dhe se fundi, Gjirokastra (35%/9) dhe Durresi (24%/9) kane patur perqindjen me te larte te komisionereve qe mendojne se zgjedhjet ne zonen e tyre kane qene te padrejta.
- Ata qe mendojne se partite kane perfituar vota te paligjshme jane pyetur se cfare hapash duhet te hidhen per te parandaluar kete fenomen. Ndryshimi qe eshte permendur me teper eshte numerimi i votave ne nje vend qendror, ne zonen zgjedhore. Te tjera pergjigje kane qene, transportimi i sigurte i fleteve te votimit, sanksione me te forta, reduktim i influences se partive politike ne proces dhe prania e mediave dhe vezhguesve nderkombetare gjate numerimit.
- Me pas komisioneret jane pyetur nese ka patur manipulim te rezultateve ne zonen e tyre. Kjo pergjigje ka demonstruar ndryshime te medha ndermjet komisionereve. Ne pergjithesi 71% (441) e komisionereve te KZZ-ve mendojne se rezultatet nuk jane manipuluar ne zonen e tyre, ndersa 20% (121) mendojne se po. Komisioneret e KZZ-ve ne Gjirokaster kane qene me skeptike me 39% (10) qe dyshojne se ka patur manipulime. Komisioneret ne Tirane (29%/32), Diber (27%/9), Durres (26%/10) dhe Fier (26%/20) kana gjithashtu dyshime se ka patur maipulime ne zonen e tyre. Si dhe ne rastin e votave te paligjshme, pergjigjet e kesaj pyetje jane pergjithesisht te lidhura me zonen.

63% (76) e atyre komisionereve te KZZ-ve qe mendojne se ka patur manipulime te rezultateve (12%/76 e komisionereve te KZZ-ve) mendojne se ne pergjithesi zgjedhjet ne zonen e tyre nuk kane qene te drejta. Ndersa 7% (45) e komisionereve qe mendojne se vendimmarrja ka qene e drejte, dyshojne se ka patur manipulime te rezultateve ne zonen e tyre.

F. Roli i Partive Politike

- Komisioneret qe jane pyetur se perse keto zgjedhje nuk kane qene me te mireorganizuara se te meparshmet (9,5%/283), kane dhene si arsye kryesore nderhyrjen e partive politike, e permendur nga 45% (126) e komisionereve. Nje perqindje e njejte (45%/1,332) mendojne se ne te ardhmen zgjedhjet ne Shqiperi mund te permiresohen nga bashkepunimi midis partive politike. 13% (384) mendojne se zgjedhjet mund te permiresohen nese partite politike perfaqesojne me mire qytetaret.

- Te intervistuarit ne kete vezhgim jane pyetur edhe sesi mund te rritet transparencja e zgjedhjeve ne Shqiperi. 29% (843) e komisionereve mendojne se zgjedhjet mund te behen me transparente me nje bashkepunim me te mire midis partive politike. 7% (184) kane shkuar me tej duke thene se komisioneret nuk duhet te emerohen nga partite politike.
- Vetem 2% (66) e anetareve te KZQV-ve dhe 0.5% (15) e anetareve te KZZ-ve do te donin qe partite politike te ishin pergjegjese per trainimin e komisionereve per zgjedhjet e ardhshme.
- 44% (1,310) jane pergjigjur se jane konsultuar me partite e tyre ne lidhje me procesin zgjedhor. Shumica e kontakteve lidheshin me pyetje rreth listave te zgjedhesve (35%/463), ngritjen e komisioneve (20%/263), zbatimin e ligjeve (10%/127), informacion ne lidhje me procesin zgjedhor (8%/104), keshilla (7%/88), dhe ceshtje logjistike (4%/51)
- Ka patur disa attribute pozitive qe i jane dhene partive politike ne kete vezhgim. 84% (2,482) e te intervistuarve mendojne se partite politike i kuptojne detyrat dhe te drejtat e perfaqesuesve te tyre ne komisione.

G. Roli i Policise


- Anetaret e KZZ-ve jane pyetur ne lidhje me marredheniet qe kane patur me policine. 72% (450) mendojne se marredheniet kane qene te mira dhe 14% (88) mendojne se marredheniet nuk kane qene te tilla.
- Ne nje pyetje tjeter jane shprehur dhe shqetesime ne lidhje me qendrimin e policise. Kur eshte kerkuar te listohen problemet kryesore qe jane vene re gjate zgjedhjeve parlamentare 2001, nje numer i konsiderueshem (10%/284) ka cituar nderhyrjen e policise si nje nga problemet. Prania e policise ne komisione eshte cituar nga 47% (134) e atyre qe mendojne se keto zgjedhje nuk kane qene me te mira se te meparshmet.
- Ajo cfare eshte interesante eshte se 38% (614) si arsye e mireorganizimit te zgjedhjeve kane permendur “mungesen e nderhyrjes se policise”.

4. PROBLEME NE ADMNISTRIMIN E ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE 2001

A. Fushat me problematike

- Komisionereve iu eshte kerkuar te listojne tre problemet me te medha qe kane hasur gjate zgjedhjeve 2001. Pjesa me e madhe e tyre (73%/2,175) kane listuar problemet me listat e zgjedhesve dhe pjesa tjeter ka listuar moskuptimin e procesit zgjedhor nga zgjedhesit (51%/1,506). Niveli i edukimit te komisionereve eshte permendur ne 39% (1,144). Nje tjeter problem i listuar ka qene mungesa e komunikimit midis KQZ dhe komisionereve (19%/552), vonesa ne ngritjen e komisioneve (18%/548), mungesa e qartesise ne manualet zgjedhore (17%/507), ndikimi i partive politike ne proces (14%/401), persona qe krijojnë probleme.

Figure 10: Problemet Kryesore Gjate Procesit Zgjedhor 2001



B. Lista e Zgjedhesve

- Anetaret e KZZ ashtu edhe ata te KZQV-ve kane raportuar probleme qe lidhen me mungesen e zgjedhesve nga lista e zgjedhesve. 91% (2,233) e komisionereve te KZQV-ve dhe 92% (569) e komisionereve te KZZ-ve kane raportuar se kane patur mungesa te zgjedhesve ne listen e zgjedhesve te zones se tyre. Kur jane pyetur per perqindjen e zgjedhesve qe mungonin ne lista, pergjigjet e tyre jane perqendruar ne 1-5 % (81%/1,805) e KZQV-ve dhe 68%/389 e KZZ-ve). Me tej 19% (105) e KZZ-ve dhe 14% (319) e komisionereve te KZQV-ve jane pergjigjur se mungesat ne lista kane qene 6-10%. Pergjithesisht ky problem eshte ngritur nga komisioneret e Tiranës dhe te zonave urbane, ndersa ato gjysemurbane dhe rurale kete problem e kane ngritur me pak.
- Problemet me listat kthehen perseri ne problemet e tjera te cituara nga anetaret e KZQV-ve ne lidhje me gabimet ne drejtshkrimin e emrave (63%/1,170), emra te vendosura gabim (39%/738) dhe emra te dublikuar (30%/573).

C. Tabela e rezultateve

- Komisioneret e KZZ-ve jane pyetur ne lidhje me mendimin e tyre per shkallen e veshteresise se hedhjes se rezultateve ne tabele. 77% (343) mendojne se hedhja e rezultateve ne tabele eshte e lehte, ndersa 23% (141) mendojne se eshte e veshtere. Nuk kishte ndonje ndryshim ne pergjigje midis komisionereve me eksperience (2 ose 4 zgjedhje) dhe atyre me pak eksperience. Pergjigjet per kete pyetje lidhen ne nje fare menyre dhe me pergjigjet e dhena ne pyetjet ne lidhje me menyren e perdorimit te formulareve te KQZ-se. Ata qe jane pergjigjur se perdorimi i formulareve ka qene i lehte, kane dhene te njejten pergjigje edhe per perdorimin e tabelës se rezultateve.
- E njetja gje edhe per ata qe jane pergjigjur se perdorimi i formulareve ka qene i veshtere.
- Ata qe e kane konsideruar kete proces te veshtere jane pyetur se si e shohin zgjidhjen. Pergjigjet me frekvente kane qene, duke lehtesuar tabelat dhe duke perdorur kompjuterat.

D. Zgjidhje te Mundshme

- Te gjithë komisionereve u eshte kerkuar te shohin nje liste te fushave te mundshme qe kerkojne permiresim. Ato me te permendurat kane qene trainim afatgjate i komisionereve (84%/2,488) dhe me pas, menaxhimi i zgjedhjeve nga KQZ (60%/1,779), bashkepunim midis partive politike (45%/1,332), si dhe kriteret per anetarsi ne KZQV e KZZ (51%/1,521). Eshte interesant fakti qe shume nga te intervistuarit mendojne se partite duhet te perfaqesojne me mire shtetasit (13%/384). Nje numer me i vogel ka dhene pergjigje si permiresimi i listave, ndryshime ne kodin zgjedhor, marredheniet midis KQZ-se dhe gjykatave, detyra specifike per policine, pagat dhe kushtet e punes per komisioneret lokale.
- Te intervistuarit jane pyetur sesi mund te rritet transparencja e procesit zgjedhor ne te ardhmen. Pergjigjet me frekvente kane qene ndryshime ne kodin zgjedhor (55%/1,622) dhe pergatitja e listave te zgjedhesve paraprakisht (38%/1,122). Informacioni ka qene gjithashtu nje nga shqetesimet kryesore te komisionereve ku shume prej tyre mendojne se duhet t'u vihet ne dispozicion informacion gjate fushates zgjedhore (25%/754) dhe se duhet te kete nje perdorim me te gjere ne media per qellime edukimi (24%/703). Shume kane thene se duhet te kete nje bashkepunim midis partive politike ne te ardhmen (28%/843). Pavaresia e komisioneve zgjedhore eshte permendur nga shume komisionere (27%/794). Se fundi eshte permendur shpesh prania e vezhguesve nderkombetare (17%/500). Pergjigje te tjera ka patur ne lidhje me nderhyrjet politike, trainimin e komisionereve, planifikimin dhe organizimin e zgjedhjeve dhe rritjen e pjesemarrjes se zgjedhesve.

5. TRAINIMI DHE PERGATITJA

A. Perdorimi i Kodit Zgjedhor dhe Manualeve

- Pothuajse te gjithë komisioneret si ne KZQV (98%/2,392) ashtu edhe ne KZZ (99%/618) kane raportuar se e kane lexuar Kodin Zgjedhor ne lidhje me detyrat e tyre si komisionere. Pyetja e metejshme ka qene se cilat jane detyrat e tyre si komisionere. Me teper se 90% e komisionereve si te KZQV-ve ashtu edhe te KZZ-ve kane percaktuar si detyre te tyre kryesore zbatimin e ligjit respektivisht ne masen (91%/2,187 dhe 95%/588). Dy pergjigje te tjera te dhena kane qene te jene te ndershem (51%/1,214 KZQV dhe 60%/373 KZZ) dhe te jene te pranishem ne mbledhje (51%/1,226 KZQV dhe 46%/282 KZZ). Pergjigje te tjera kane qene promovimi i harmonise brenda komisionit (21%/497 KZQV dhe 23%/141 KZZ) dhe ruajtja e marredhenieve te mira me qeverisjen vendore (14%/329 KZQV). Promovimi i harmonise eshte permendur nga komisioneret e Vlores dhe Fierit.
- Komisioneret e KZQV-ve dhe KZZ-ve kane marre gjithashtu edhe manualet perkates per t'u ndihmuar ne punen e tyre. Pjesa me e madhe e tyre i ka konsideruar manualet si te lehte per t'u perdorur (KZQV 88%/2,160 te lehte dhe 11%/278 te veshtire; KZZ 92%/574 te lehte dhe 8%/48 te veshtire) dhe pjesa me e madhe e tyre eshte pergjigjur se i kane perdorur keto manuale gjate kryerjes se detyrave te tyre (KZQV 99%/2,422 dhe KZZ 100%/622).

B. Perdorimi i Trainimit

- Komisioneret si te KZQV-ve ashtu edhe te KZZ-ve jane pyetur ne lidhje me trainimin e kryer perpara zgjedhjeve parlamentare 2001. 79% (1,921) e punonjesve te KZQV-ve dhe 85% (527) e anetareve te KZZ-ve raportuan se kane marre pjese ne trainimin

e organizuar per zgjedhjet parlamentare 2001. Ne trainim nuk kane marre pjese kryesisht komisioneret e KZQV-ve dhe KZZ-ve te prefektures se Tiranes.

C. Mendimi ne lidhje me trainimin

- Komisionereve qe kane marre pjese ne trainim u eshte kerkuar te thone nese jane ose jo dakord me vleresimet e meposhtme:
 - Programi i Trainimit është i nevojshëm
 - Programi i Trainimit ishte i mirëorganizuar
 - Trainuesit ishin në gjendje t'u jepnin përgjigje pyetjeve tona
 - KQZ duhet të jetë i pranishëm në programet e trainimit
 - Programi i trainimit ishte i kuptueshem
 - Manualat ishin nje ndihmesë e mirë për komisionerët
 - Manuali është forma e vetme që duhet përdorur për trainimin
 - Komisionerët duhet të trainohen perpara cdo zgjedhjeje
 - Në postin e komisionerit duhet të jene vetem komisioneret e trainuar

KZQV-te

- Komisioneret e KZQV-ve ishin shume entuziaste ne lidhje me trainimin e kryer. Pothuajse te gjithe komisioneret e KZQV-ve kane marre pjese ne programin e trainimit dhe 99,6% (1,913) e tyre jane dakord me faktin se trainimi eshte i nevojshem; 92% (1,773) mendojne se trainimi ishte i mireorganizuar dhe 95% (1,830) mendojne se trainuesit ishin ne gjendje te jepnin përgjigje pyetjeve perkatese.
- Prania e KQZ-se ne trainim mendohet e domosdoshme nga 96% (1,846) e komisionereve.
- 99% (1,895) e komisionereve mendojne se manualat ishin nje ndihmese e mire per komisioneret, por gjysma nuk eshte dakord se manualat jane e vetmja forme trainimi qe duhet perdorur. Sa me e madhe te ishte eksperiencia ne zgjedhje, aq me shume komisioneret ishin te prirur te theksonin se manualat nuk duhet te ishin e vetmja forme trainimi.
- 99% (1,914) e komisionereve jane dakord se duhet te trainohen perpara cdo procesi zgjedhor dhe 97% (1,866) jane dakord se trainimi duhet te jete i detyrueshem per cdo komisioner.
- Komisioneret qe kane marre pjese ne trainim jane pyetur se si mund te permiresohet ky trainim ne te ardhmen. Pergjigjet me frekvente kane qene: me teper kohe, grupe me te vogla dhe nje cilesi me e larte e udhezimeve. Eshte permendur shpesh edhe permiresimi i logjistikes, sidomos shperndarja e materialeve perpara trainimit.
- Komisioneret qe nuk kane marre pjese ne trainim jane pyetur nese jane ose jo dakord me vleresimet e meposhtme:

KQZ duhet të jetë i pranishëm në programet e trainimit
Manualat ishin nje ndihmesë e mirë për komisionerët
Manuali është forma e vetme që duhet përdorur për trainimin
Komisionerët duhet të trainohen perpara cdo zgjedhjeje
Në postin e komisionerit duhet të jene vetem komisioneret e trainuar

- Pergjigjet nuk ishin shume te ndryshme nga ato te atyre komisionereve qe kishin marre pjese ne trainim, me perjashtim te faktit se manuali nuk duhet te jete forma e

vetme e trainimit ku nuk ishin dakord 60% (313) e te intervistuarve ne krahasim me 50% (968) si dhe me mendimin se trainimi duhet te jete i detyrueshem per cdo komisioner (12%/63 krahasuar me 3%/49).


KZZ

- Komisioneret e KZZ-ve jane nje pasqyre e kolegeve te tyre te KZQV-ve, ne vleresimet qe kane bere per trainimin. Pothuajse 100% e atyre qe kane marre pjese ne trainim mendojne se trainimi eshte i nevojshem (99.9%/526), 80% (422) mendojne se trainimi ishte i mireorganizuar dhe 90% (473) mendojne se trainuesit mund t'u jepnin pergjigje pyetjeve te tyre.
- 93% (492) e anetareve te KZZ-ve mendojne se KQZ duhet te jete e pranishme gjate trainimit.
- 98% (517) mendojne se manualet ishin te nevojshem, por pjesa me madhe (61%/324) mendojne se manualet nuk duhet te jene e vetmja forme trainimi.
- Pothuajse te gjitha mendojne se trainimi duhet te jete i detyrueshem dhe duhet te organizohet perpara cdo zgjedhjeje respektivisht (97%/510 dhe 99%/525).
- Komisioneret e KZZ te cilet kane marre pjese ne trainim kane pothuaj te njejtat mendime me komisioneret e KZQV-ve ne lidhje me menytrat e permiresimit te trainimit. Ata gjithashtu kane permendur me teper kohe, grupe me te vogla, cilesi me te larte te udhezimeve, permiresimin e logjistikës dhe shperndarjen e materialeve perpara trainimit.
- Anetaret e KZZ-ve te cilet kane marre pjese ne trainim jane pyetur ne lidhje me te njejtat pyetje sikurse edhe anetaret e KZQV-ve dhe me teper se 90% (87) e tyre mendojne se KQZ duhet te jete e pranishme ne sesionet e trainimit, trainimi duhet te jete i detyrueshem dhe te kryhet perpara cdo procesi zgjedhor si dhe manualet jane konsideruar te nevojshem. Ky grup ishte me i prirur te mos binte dakord me faktin se manualet jane e vetmja forme trainimi e nevojshme (73%/69).

D. Shoqata e Zgjedhjeve

- Gjate ketij vezhgimi komisioneret u pyeten se cili ishte mendimi i tyre ne lidhje me krijimin e nje shoqate zgjedhjesh ne Shqiperi. 84% (2,499) e te intervistuarve mendojne se kjo shoqate eshte shume e nevojshme ndersa vetem 12% (348) mendojne se nuk eshte e nevojshme. Komisioneret e Tiranes dhe zonave te tjera urbane ishin me pak te mendimit se kjo shoqate eshte nevojshme ne krahasim me ata te zonave te tjera. Komisioneret ne zonat me pak te populluara mund ta shohin kete shoqate edhe lidhur me largesine relative te zones perkatese. Komisioneret ne Vlore, Durres, Kukes dhe Shkoder, ishin me teper te mendimit se kjo shoqate nuk eshte e rendesishme.
- 57% (1,707) e te intervistuarve kane deklaruar se do te marrin pjese patjeter ne kete shoqate, ndersa 29% (853) mendojne se do te marrin ne konsiderate pjesemarrjen ne te. Anetaret e KZZ-ve ishin me te bindur ne pjesemarrjen e tyre ne kete shoqate (63%/392 ne krahasim me 57%/ 1,384 e KZQV-ve). Komisioneret e Durresit dhe te Vlores ishin me te prirur ndaj mospjesemarrjes ne kete shoqate. Cuditerisht, komisioneret e zonave rurale dhe gjysme urbane te cilet ishin me teper ne mbeshtetje te idese se krijimit te shoqates, nuk ishin shume te bindur ne pjesemarrjen ne te, sikurse komisioneret e Tiranes.

Figure 11: Nevoja dhe Pjesemarrja ne Shoqaten Zgjedhore



E. Media Efektive per Komisioneret dhe Zgjedhesit

- Komisioneret u pyeten ne lidhje me menyrat me efektive te edukimit te zgjedhesve ne lidhje me procesin e votimit. 64% (1,890) e te intervistuarve kane permendur si mjetet me efektive radion dhe televizionin. Metoda te tjera qe jane konsideruar efektive jane njoftimet e KQZ-se ne gazeta (33%/ 974), takime te ndryshme (32%/948), njoftime me poste (26%/770), konferenca shtypi te KQZ (24%/722), postera (24%/722), fletpalosje/broshura (22%/649), artikuj ne gazeta/revista (10%/291) dhe banderola (5%/143).


6. VLERESIMI PER KOMISIONIN QENDROR TE ZGJEDHJEVE

Ne pergjithesi, KQZ-ja dhe stafi i tij jane konsideruar si mjaft kompetente dhe te besueshem ne kryerjen e detyrave te tyre gjate zgjedhjeve parlamentare 2001. Materialet dhe udhezimet e shperndara nga KQZ perpara dhe gjate zgjedhjeve jane menduar te jene me te thjeshta.

A. Komunikimi me KQZ

- Komisioneret kane raportuar se ka nje ndryshim midis menyres se komunikimit te KQZ-se me anetaret e KZZ-ve dhe KZQV-ve. Anetaret e KZZ-ve ishin me te prirur te kontaktonin komisioneret kryesore si Kryetarin, anetaret e KQZ sesa anetaret e KZQV-ve. Nga ana tjetere, anetaret e KZQV-ve ishin dy here me teper te prirur ndaj kontaktimit te koordinatorit te prefektures. Duhet theksuar se koordinatori i prefektures nuk eshte punonjes i KQZ-se. Ndryshime sjell gjithashtu edhe shperndarja gjeografike. Eshte e pritshme qe komisioneret e Tiranës te jene me te prirur ndaj kontaktimit te KQZ-se ndersa ne vende te tjera me teper kontakte jane krijuar me kordinatoret e prefektures. Ne pergjithesi, 44% (1,296) e komisionereve kane patur kontakte kryesisht me kordinatoret e prefektures, 15% (437) me anetaret e KQZ-se dhe supervizoret (442), 10% (305) me inspektoret e KQZ-se dhe 5% me kryetarin (145) dhe sekretarin e KQZ-se (134).


Figure 12: Anetaret dhe Punonjesit e KQZ me te Kontaktuar Gjate Zgjedhjeve 2001



B. Asistenca e ofruar nga KQZ


- Ne pergjithesi, komisioneret lokale kane vleresuar lart asistencen e dhene nga KQZ gjate zgjedhjeve parlamentare 2001. Perqindja e te intervistuarve qe mendojne se asistenca e ofruar ka qene ‘shume e mire’ dhe ‘e mire’ eshte mjaft e larte per cdo rast: KQZ (69%/2,047), Inspektorët e KQZ-së (65%/1,948), Supervizorët e KQZ (72%/2,149), Kordinatorët e Prefekturës (88%/2,613). Shkalla e larte e pergjigjeve qe lidhen me kordinatoret e prefektures ka te beje me faktin se pothuajse te gjithë te intervistuarit kane marre nje fare asistence nga keta funksionare, ndersa 15 – 20 % e te intervistuarve nuk jane asistuar nga asnje nga punonjesit e listuar. Ky fakt reflekton gjithashtu edhe pranine e kordinatoreve ne terren dhe me prane ketyre komisionereve.
- Ka disa ndryshime rajonale ne nivelin e kontakteve me inspektorët dhe supervizorët e KQZ. Ne Durres, Lezhe dhe Fier, komisioneret kane qene te prirur te thone se nuk kane patur asistence nga inspektorët dhe supervizorët. Nga ana tjeter komisioneret ne Gjirokaster dhe Shkoder kane thene se kane patur asistence nga supervizorët dhe inspektorët. Gati dyfishi i anetareve te KZQV-ve ne krahasim me ata te KZZ-ve kane deklaruar se nuk kane patur asistence nga ana e inspektoreve te KQZ-se.
- Pavaresisht se pjesa me e madhe e te intervistuarve e kane vleresuar lart punen e KQZ-se, perseri kane dhene mendime ne lidhje me menytrat e permiresimit te komunikimit te KQZ-se me komisioneret me menytrat ne te cilat KQZ mund t’i asistojne ne te ardhmen. Menytrat e ndryshme per permiresimin e komunikimit ishin: telefoni dhe faksi (75%/2,221); me teper takime me KQZ-ne (61%/1,816); pergatitja dhe dhenia ne kohe e udhezimeve (51%/1,516); dhe me teper vizita nga stafi i KQZ-se (45%/1,336). Mungesa e telefonit dhe faksit ka qene nje nga ankesat me frekvente.

Figure 13: Metoda per Permiresimin e Menyres se Komunikimit te KQZ me Komisioneret



- Persa i perket menyrave ne te cilat KQZ mund te asistojne ne te ardhmen, sugjerimet kane qene: kontakte te rregullta (61%/1,801); zgjidhje e shpejte e problemeve (56%/1,675); paanesia (43%/1,264); disponueshmeri ne cdo kohe (41%/1,208); shpejtesia ne veprime (39%/1,149) dhe informim i komisionereve ne lidhje me rolin e tyre (16%/472). Komisioneret e opozites ishin me te prirur te permendin paanesine e KQZ-se.

Figure 14: Metoda ne te Cilat KQZ Mund te Asistojne ne te Ardhmen



- Ka patur pak shqetesim ne lidhje me paanesine e inspektoreve dhe supervizoreve te KQZ-se gjate punes se tyre per zgjedhjet parlamentare 2001. Persa i perket inspektoreve 84% (2,487) mendojne se inspektoret nuk kane shfaqur njeanshmeri gjate punes se tyre, 4% (139) mendojne se po, dhe 12% (346) nuk i jane pergjigjur kesaj pyetje, ndersa per supervizoret 85% (2,514) mendojne se nuk kane shfaqur njeanshmeri gjate punes se tyre, 4% (118) mendojne se po dhe 11% (340) nuk i jane pergjigjur pyetjes. Perqindja e atyre qe nuk kane dhene pergjigje eshte mjaft e larte per prefekturen e Tiranes, gjithashtu komisioneret e prefektures se Tiranes, kane perqindjen me te larte te pergjigjeve ne lidhje me te qenit te njeanshem. Normalisht mendohet se ata qe mendojne se ka patur njeanesi kane preferuar te mos japin nje pergjigje per kete pyetje, por nga ana tjetere fakti qe me teper se 80% e komisionereve ne cdo rast kane thene se nuk ka patur njeanshmeri, flet per integritetin e punonjesve te KQZ-se gjate zgjedhjeve te fundit.

C. Dokumentacioni i KQZ-se

- Me teper se 9 te intervistuar ne 10 jane pergjigjur se i njohin vendimet dhe udhezimet e KQZ-se ne lidhje me procesin zgjedhor. Shume pak, vetem 8% (222) kane thene se nuk i njohin keto dokumenta. Komisioneret nga Kukesi (28%/59) dhe Shkodra (14%/37) kane deklaruar se nuk jane njohur me dokumentat e KQZ-se.
- Kjo pergjigje, ne lidhje me mosnjohjen e dokumentacionit te KQZ-se eshte hasur me shpesh ne zonat rurale ne krahasim me ato urbane dhe gjysme urbane.
- Te intervistuarve u eshte kerkuar te vleresojne shkallen e lehtesise se dokumentave te KQZ-se. Pothuaj 90% mendojne se keto dokumenta jane te lehta dhe shume te lehta per t'u kuptuar: Kodi Zgjedhor (89%/2,654); vendimet e KQZ-se (92%/2,744); udhezimet e KQZ-se (92%/2,729); manualet e KZQV-se dhe KZZ-se (93%/2,759) dhe formularet e KQZ-se (89%/2,643).
- Komisioneret u pyeten gjithashtu edhe ne lidhje me faktin nese keto dokumenta jane te detyrueshem per zbatim ose jo. Pergjigjet kane qene Kodi Zgjedhor (99%/2,933), vendimet dhe formularet e KQZ-se (95%/2,813). Ne lidhje me udhezimet e KQZ-se (78%/2,325) mendojne se ato jane te detyrueshme dhe 20% (591) i konsiderojne si fakultative.
- Si per KZZ ashtu edhe KZQV komisioneret qe nuk kane marre pjese ne trainim jane me teper te mendimit se keto dokumenta jane te veshtire per t'u kuptuar. Gjithashtu ata qe kane marre pjese ne trainim mendojne se keto dokumenta jane te detyrueshme dhe vlere e trainimit duket qarte ne baze te ketyre te dhenave. Ne rastin e udhezimeve dhe manualeve te KQZ-se, komisioneret me te rinj jane me teper te mendimit se keto dokumenta jane fakultative.
- Te intervistuarit u pyeten se sa i here i kane marre ne kohe per zbatim udhezimet dhe vendimet e KQZ-se. Pjesa me e madhe e tyre (82%/2,425) mendojne se jane marre ne kohe "shpesh" ose "gjithmone"; 16% (477) mendon se jane marre ne kohe "ndonjehere" dhe 2% (66) mendon se nuk jane marre "kurre" ne kohe. Ne sa me shume procese zgjedhore te kishin punuar komisioneret aq me kritike ishin ndaj afateve te marrjes se ketyre dokumentave.
- Se fundi, te intervistuarit u pyeten nese ishin njohur me materiale edukative te KQZ-se ne media gjate periudhes se zgjedhjeve. Pergjigjet per kete pyetje nuk ishin

inkurajuese. Vetem 50% (1,499) e te intervistuarve kane marre njoftime te KQZ-se gjate procesit zgjedhor dhe vetem 52% (1,530) kane ndjekur emisionet televizive te KQZ-se. Perqindjet fillojne me pas te bien: konferenca per shtyp te KQZ-se (45%/1,332), postera (41%/1,208), video (36%/1,078), fletpalosje/broshura (28%/834), artikuj gazete (23%/695), stilolapsa me 811 (15%/449), banderola (8%/251), manuale (2%/50) dhe faqen e KQZ-se ne internet (1%/35).

7. DEMOKRACIA

A. Kuptimi i Termit “Zgjedhje te Lira e te Ndershme”

- Komisioneret u pyeten se cfare mendojne ne lidhje me termin zgjedhje te lira e te ndershme. Pergjigjet kryesore ishin liri dhe transparence. Pergjigjet me te permendura ishin liria per te votuar (56%/1,665), transparence e procesit zgjedhor (41%/1,211), te tjera ishin paanesi gjate zgjedhjeve (34%/1,000), zgjedhje pa presion mbi votuesit (33%/986), trajtim i njejte per te gjitha (23%/697) dhe bashkepunim midis partive politike (9%/277). Se fundi eshte e rendesishme te permendet se ne pergjithesi komisioneret duket se jane te qarte ne lidhje me standartet e pranuar nderkombetare per zgjedhje te lira e te ndershme si transparence, konkurim te barabarte dhe lirine e ushtrimit te te drejtes se votes.

B. Kuptimi i te Jetuarit ne Demokraci

- Demokracia eshte kuptuar ne pergjithesi si nje sistem qeverisjeje i cili i lejon njerezit te marrin pjese ne veprimtarite e drejtimit te shtetit dhe thekson lirine e veprimit, barazine dhe shtetin ligjor. Zgjedhjet jane pa dyshim, menyra me e qarte nepermjet te ciles shtetasit marrin pjese ne drejtimin e shtetit. Keshtu ka qene me interes per KQZ-ne dhe IFES te shohin se cfare mendojne komisioneret me fjalen demokraci. 72% (2,154) kane permendur shtetin ligjor si nje nga kuptimet e demokracise. 54% (1,590) mendojne respektimin e dinjitetit te personit dhe 54% (1,593) mendojne se demokraci do te thote “te jetosh i lire”. Keto vleresime pasqyrojne imazhin ideal qe kane komisioneret per demokracine. Por ka edhe nje logjike ne keto pergjigje. Shume komisionere permendin edhe “mundesi ekonomike” (32%/962), nje te ardhme te sigurte (29%/848) dhe “liri per te punuar” (27%/810) keshtu pervec anes ideale te demokracise, komisioneret e shohin edhe si nje mundesi ekonomike.

PJESA E TRETE: Komente dhe Vleresime te IFES

1. PERBERJA DEMOGRAFIKE E KOMISIONEVE ZGJEDHORE

Rezultatet e vezhgimit tregojne se anetaresia e komisioneve zgjedhore ne Shqiperi nuk reflekton profilin demografik ne Shqiperi. Gjithashtu, nuk jane permbushur kerkesat e kodit zgjedhor ne lidhje me nivelin arsimor te komisionereve lokale.

- Perfaqesimi i grave duket mjaft i ulet. Barazia ne kete drejtim nuk eshte kerkesa e ligjit; megjithate duhet te arrihet nje vendosmeri e larte nga partite politike ne menyre qe te krijoje nje barazi te sekseve ne perfaqesim. KQZ mund te vendose kerkesa ne menyre qe partite te rritnin pjesemarrjen e grave ne komision.
- Anetaret e komisioneve emerohen nga partite politike. Pervec faktit qe nuk ka shume gra te emeruar ne komisione, duket sa partite i kane neglizhuar kerkesat e Kodit Zgjedhor lidhur me faktin se komisioneret duhet te jene me arsim te larte. KQZ duhet te jete me rigoroz ne zbatimin e kerkesave qe ka kodi ne lidhje me nivelin arsimor. Por eshte gjithashtu e ditur se neqoftese partite nuk i emerojne komisioneret deri ne minuten e fundit, kjo krijon veshtiresi per te mos thene pamundesia nga ana e KQZ-se per te verifikuar keto kandidatura dhe per te bere emerimet ne perputhje me afatet e kodit zgjedhor. Rrjedhimisht, ndersa partite duhet t'i permbahen kerkesave te kodit zgjedhor, KQZ duhet te marre ne konsiderate percaktimin e procedurave administrative per emerimet, qe do t'i jepnin KQZ-se me teper kohe per te ripare keto kandidatura dhe per te njoftuar partite ne lidhje me kandidaturat e papranueshme te paraqitura.
- Gjate periudhes midis zgjedhjeve KQZ ka mundesine e korrjigimit te disa fushave qe nuk perputhen me kodin zgjedhor, ose te kerkoje ndryshimin e dispozites perkatese nese vihet re pamundesia e zbatimit te saj. Rishikimi i procedurave administrative duhet te perfshije edhe gjetjen e menyrave per perfshirjen e grave ne perfaqesimin ne komisione zgjedhore.
- Te dhenat e ketij vezhgimi tregojne se vetem 18% e komisionereve jane te moshave 18-35 vjec. KQZ duhet te inkurajoje partite politike te emeroje ne komisione kryesisht kete grup moshe, per te inkurajuar nje pjesemarrje me te gjere te rinjve ne procesin zgjedhor.

2. PERFAQESIMI I PARTIVE POLITIKE DHE KUPTIMI I PERGJEGJESIVE NGA KOMISIONERET

- Struktura e administrimit te zgjedhjeve ne Shqiperi mbeshtetet ne komisionet e perbera nga perfaqesues te partive politike. Kjo procedure ka pikat e saj te forta e te dobeta. Duke qene se partite politike emeroje anetare ne komisione dhe zakonisht emerojne militante per te perfaqesuar interesat e partise, KQZ ne nivel lokal paraqitet me disa veshtiresi. Problemi i emerimit te komisionereve nga partite politike, identifikohet edhe ne kete vezhgim nga komisioneret. Kur jane kerkuar te listojne detyrat e tyre, nje pjese e madhe ka thene; zbatimi i ligjit; lejimi i zgjedhesve te votojne lirisht; njohja e ligjit dhe manualeve te KQZ-se; figura e paster morale. Megjithate kur jane pyetur se para kujt jane pergjegjes si komisionere, vetem 64% e komisionereve te KZQV-ve dhe 71% e atyre te KZZ-ve kane percaktuar si te tille KQZ-ne. 34% kane percaktuar si te tille partine qe i ka emeruar.

- Logjika e kodit zgjedhor ishte se pasi komisioneret emerohen nga KQZ, ata duhet t'i sherbejne me ndershmeri publikut nen derjtimin e KQZ-se. Komisioneret lokale jane ne thelb punonjes te KQZ-se dhe nuk emerohen ne komision per t'i sherbyer interesave te partise perkatese. Fakti qe 1/3 e komisionereve kane percaktuar se ndihen pergjegjes perpara partise se tyre dhe fakti qe partite i nderrojne vazhdimisht perfaqesuesit e tyre perpara zgjedhjeve, theksojne edhe nje here kete problem qe ishte ndeshur nga KQZ. Eshte e rendesishme qe KQZ te gjeje menyra per te reduktuar influencen e partive politike ndaj komisionereve dhe te forcoje mendimin e komisionereve se duhet t'i lene menjane interesat e partise pas emerimit te tyre ne komision. Eshte gjithashtu e rendesishme qe KQZ te qartesoje bazat ku mbeshtetet KQZ per te pranuar zevendesimin e nje komisioneri zgjedhor.
- Emerimi i perfaqesuesve te partive politike ne komisionet lokale (nenet 33 dhe 39 te kodit) duhet te beje te mundur qe anetaret e komisioneve "te shkunden" nga mendimi se i sherbejne partise qe i ka zgjedhur dhe te kuptojne se duhet t'i sherbejne te mires se komunitetit ne pergjithesi. Megjithate, kjo procedure nuk eshte ndjekur, ose sepse partite mendojne se te emeruarit e tyre ne komisione jane te mjaftueshem ose sepse mendojne se nuk kane njezere per t'i emeruar si perfaqesues. (Kjo lidhet kryesisht me KQV-te te cilat nuk ishin perfshire ne kete vzhgim). Eshte e qarte se ka shume pune per te bere me partite politike dhe komisioneret ne kete fushe. Gjithashtu disa modifikime te kodit zgjedhor lidhur me perfaqesuesit e partive ne komisione mund te jene te nevojshme.
- Te dhenat e ketij vzhgimi tregojne se disa nga shqetesimet qe lidhen me partite politike ndikojne negativisht punen e komisionereve. Pervec konflikteve ndermjet partive politike, shqetesimi kryesor eshte menyra sesi komisioneret e mendojne veten. Kur jane pyetur se si e konsiderojne rolin e tyre si komisioner me shume se 1/3 e tyre (34%) e shohin veten si perfaqesues te partise politike qe i ka emeruar. Duke e kombinuar kete me faktin se 39% e te intervistuarve mendojne se komisioneret kane patur presione nga partite politike qe i kane emeruar, kjo tregon se komisioneret gjate zgjedhjeve parlamentare 2001 jane drejtuar me teper nga perkatesia e tyre politike sesa nga interesi publik. Keto ceshtje mund te adresohen nepemjet programeve te trainimit dhe edukimit, por nga ana tjeter duhet te jene subjekt i dialogjeve te metejshme ndermjet KQZ-se dhe partive politike.

3. PUNA GJATE ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE 2001

- Te intervistuarit kane patur mendime te ndryshme ne lidhje me administrimin e zgjedhjeve. Keshtu, 55% mendojne se keto zgjedhje kane qene me te mireadministruara se te meparshmet. Megjithate, vetem 50% e anetareve te KZZ-ve kane te njejtin mendim (edhe pse perqindjet rriten me pergjigjet e atyre komisionereve qe kane qene anetare komisionesh ne zgjedhjet e meparshme). Perqindja me larte e anetareve te KZQV-ve qe mendojne se zgjedhjet jane me te mira krahasuar me zgjedhjet e vitit 2000 dhe 2001 e lidhin kete me listat e zgjedhesve. Mendimet jane te ndryshme me Gjirokastren dhe Fierin qe japin nje miratim te gjere dhe Vloren, Shkodren, Dibren e Tiranen, ku miratimi eshte me i ulet. Ne te njejtin kohe, KQZ eshte vleresuar lart per asistencen e ofruar nga kryetari, inspektoret, supervizoret dhe ky vleresim eshte dhene edhe per koordinatoret e prefektures.
- Mendimi se zgjedhjet nuk kane qene me te mira se te meparshmet, ka qene me i forte ne zonat urbane dhe ne zonat ku ditin e zgjedhjeve ka patur probleme me listat. Rrjedhimisht, eshte e nevojshme qe KQZ te perpiqet te perqendohet ne keto zona dhe te studioje ceshtjet e ndryshme te ngritura nga komisioneret per te permiresuar administrimin e zgjedhjeve te ardhshme. Me saktesisht, ne prefekturat e Tiranës, Durrësit, Vlores, Shkodres dhe Dibers, jane te nevojshme inisiativa ne pastrimin e

listes se zgjedhesve, hartat, trainimi, edukimi qytetar dhe bashkepunimi me partite politike.

- Pjesa me e madhe e anetareve te KZQV-ve dhe KZZ-ve mendojne se marredheniet midis komisionereve kane qene 'shume te mira' ose 'te mira' dhe se vendimmarrja ne komisionin e tyre ka qene e drejte. Megjithate 15% e anetareve te KZZ-ve mendojne se vendimmarrja ne komisionin e tyre nuk ka qene e drejte. Anetaret e KZZ-ve ne prefekturat e Durresit, Dibres, Fierit, Gjirokastrës dhe Tiranes, ishin me te prirur ndaj mendimit per vendimmarrje te padrejte. Ndersa 15% e komisionereve kane thene se vendimmarrja ne komisionin e tyre nuk ka qene e drejte, 20% mendojne se rezultatet ne zonen e tyre jane manipuluar. Kur jane pyetur nese mendojne se partite politike kane perfitur vota ne menyre te paligjshme (kjo ka qene nje pyetje e pergjithshme dhe jo drejtuar zonen specifike) 34% e anetareve te KZZ-ve jane pergjigjur se po. Keto mendime kane qene me te forta ne Shkoder, Kukes, Durres dhe Tirane. Eshte e nevojshme qe KQZ t'i kushtoje vemendje te vecante ketyre prefekturave per te siguruar se ne te ardhmen zgjedhjet te mbahen ne nje atmosfere me te hapur e transparente. Vemendja e vecante ndaj ketyre prefekturave perfshin menytrat e permiresimit te listave te zgjedhesve, krijimin e mendimit se komisioneret punojne per KQZ-ne dhe jo per partite politike, sigurimi i nje bashkepunimi te ngushte me partite politike ne ceshtjet qe lidhen me administrimin e zgjedhjeve, trainimin dhe edukimin qytetar.

Ankesat

- Nuk eshte per t'u cuditur qe pjesa me e madhe e ankesave lidhen me listat e zgjedhesve. Problemi me kryesor ka qene mungesa e personave ne lista ose vendosja ne qendrat e gabuara te votimit; gabime ne informacionin qe permbajne listat dhe procedurat e gjykates ne lidhje me mundesine per te votuar per personat qe nuk jane ne liste. Shqetesimet qe lidhen me listen e zgjedhesve duhet te jene prioriteti kryesor i KQZ-se per zgjedhjet lokale 2003. Vemendje i duhet kushtuar rishikimit te kufijve te qendrave te votimit ne zonat urbane si dhe pergatitjes se hartave per qendrat e votimit. Saktesisht jane 11 qytete qe duhet te trajtohen me prioritet nga KQZ ne perpjekjet per permiresimin e listave te zgjedhesve.

Probleme ne Administrimin e Zgjedhjeve

- Problemi me kryesor jane listat e zgjedhesve. Ceshtje te tjera lidhen kryesisht me nevojen per nje fushate edukimi qytetar., vonesa ne ngritjen e komisioneve, nevojen per trainim te metejshe me komisionereve dhe nderhyrjet e partive politike. Disa nga keto probleme jane permendur me lart si fusha qe kerkojne vemendjen e KQZ-se. Gjithashtu eshte e rendesishme per KQZ-ne te vazhdoje nje fushate te gjere te edukimit qytetar per edukimin e zgjedhesve, te vazhdoje permiresimin e metejshe me materialeve dhe veprimtarive te trainimit dhe se fundi, te punoje me partite politike per te siguruar

funksionimin e plote te komisioneve lokale perpara periudhes se zgjedhjeve.

- Ne lidhje me kete fakt, KQZ mund te marre ne konsiderate marrjen e nje vendimi ne lidhje me afatin ne te cilin partite duhet te zgjedhin komisioneret dhe kufizimin e mundesive te partive per te ndryshuar anetaret. Gjithashtu KQZ, duhet te percaktojte procedura qe do te kufizonin nderhyrjen e partive politike ne procesin zgjedhor ne nivelin e komisioneve lokale.
- Tete perqind e te intervistuarve kane cituar problemet me policine. Kjo pergjigje nuk eshte e shpeshte duke marre parasysh raportet e medias pas zgjedhjeve. Megjithate eshte e rendesishme qe roli i policise ne komisionet zgjedhore ne ditën e zgjedhjeve

dhe ne veprimtari te tjera qe lidhen me administrimin e zgjedhjeve, te jete nen drejtimin dhe udhezimet e KQZ-se dhe te jete transparent per te gjitha pjesemarresit - partite politike, median dhe publikun. KQZ-ja duhet te marre nje pozicion aktiv ne lidhje me kete ceshtje dhe se bashku me Ministrine e Rendit Publik, te hartoje udhezime te qarta ne lidhje me veprimtarine e policise dhe autoritetin e KQZ-se ne ditën e zgjedhjeve.

Trainimi dhe Shoqata e Komisionereve Zgjedhore

- Te intervistuarit kane theksuar nevojën e trainimit te metejshe. Nje pjese e madhe kane qene te mendimit se trainimi duhet te jete i detyrueshem. KQZ-ja mund te marre ne konsiderate nje rregullore te tille e cila percakton shkarkimin e anetareve qe nuk marrin pjese ne trainim.
- Nje pjese e madhe e te intervistuarve kane qene ne favor te krijimit te nje Shoqate te Komisionereve Zgjedhore. Krijimi i kesaj shoqate ka filluar tashme, megjithate ka nevojë per nje mbeshjtetje te vazhdueshme nga KQZ-ja. Kjo mbeshjtetje mund te kerkoje asistencë fillestare (stafi, morale dhe financiare) si ne kete moment edhe ne te ardhmen. Gjithashtu, vlera e kesaj shoqate per KQZ-ne do te behet e qarte nepermjet konsultimit dhe bashkepunimit te vazhdueshem me shoqaten, ne nje sere ceshtjesh si trainimi, edukimi qytetar, reforma e procesit zgjedhor dhe hartimi i udhezimeve dhe reformes ligjore. KQZ duhet te marre iniciativen ne lidhje me kete ceshtje.

Edukimi Qytetar dhe Perdorimi i Medias si Mjet Informimi per Komisionet Lokale

- Pavaresisht nga shfaqjet e videove trainuese dhe njoftimeve te KQZ-se per te komunikuar me komisioneret ne stacionet televizive ne mbare vendin, nje numer shume i vogel te intervistuarish raportoi se i ka pare. Ky fakt mund te jete rezultat i shume arsyeve qe perfshijne oraret e punes, mungesen e informacionit ne lidhje me oraret e transmetimit. Perdorimi i medias per te informuar komisioneret mund te jete i nevojshem ne te ardhmen. Megjithate, eshte po aq e rendesishme qe KQZ te beje te mundur qe komisionet lokale te kene ne sherbim telefon dhe faks ne menyre qe te shkembejne informacione me KQZ-ne.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

- Ne pergjithesi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve eshte vleresuar mjaft mire nga komisioneret per asistencen e ofruar gjate zgjedhjeve te Qershorit 2001. Megjithate ka perseri vend per permiresim. Kontakti i vazhdueshem i anetareve te KQZ-se me komisioneret, pjesemarrja e tyre ne programet e trainimit si dhe nje perdorim i njohurive te inspektoreve dhe supervizoreve ne terren jane te nevojshme. Si nje institucion i pavarur, KQZ, duhet te reduktoje varesine e tij nga perdorimi i kordinatorëve te prefektures. Roli i tyre mund te kryhet nga inspektorët (ndermjet zgjedhjeve) dhe supervizoret (gjate zgjedhjeve).

KQZ duhet te planifikoje nevojën qe ka nje lidhje me infrastrukturen ne menyre qe te realizoje kete fakt (komunikimi, pajisjet, transporti dhe ne disa raste edhe zyra lokale gjate zgjedhjeve). Ne lidhje me kete fakt, KQZ-ja duhet te perqendrohet me teper ne ato prefektura ku ka patur me teper ankesa dhe probleme qe jane ngritur nga komisioneret.

SHTESE 1 – Pyetësi për Komisionerët



Ky Vezhgim Studimor dhe Botimi i tij u mundesua me ane te fondeve te dhena nga Agjensia e Shteteve te Bashkuara per Zhvillim Nderkombetar

